

## STATUTI I SHOQËRISË

### "JOEN Village" SHPK

Ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar si dhe te Ligjit 9723, date 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit nr 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", ne :

Irfan Balla, i biri i Teufik, shtetas shqiptar, lindur më 10/03/1964 në Durrës, Shqipëri , banues në Durrës , identifikuar me letërnjoftim nr 034491414 dhe Nr personal G40310336P, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nën cilësinë e Ortakut të shoqërisë ,

dhe

Albana Likaj, e bija e Alitit, shtetase shqiptar, lindur më 18/11/1972 në Durrës, Shqipëri, banuese në Durrës, identifikuar me letërnjoftim nr 027913058 dhe Nr personal H26118087G, madhorE dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nën cilësinë e Ortakut të shoqërisë ,

shpallim si me poshte vijon:

### FORMIMI I SHOQËRISË

#### Neni 1

Sot me 01/12/2019, Themelohet shoqeria e quajtur "JOEN Village" SHPK

me ortakë:

1. **Irfan Balla** me ID G40310336P .
2. **Albana Likaj** me ID H26118087G .

### QENDRA E SHOQËRISË

#### Neni 2

Selia e shoqerise do të jetë në adresën : Llange, Librazhd, Zona kadastrale 2477, Nr i Pasurisë 283/2, Shqipëri .

Shoqëria mund të themelojë dege dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij me miratimin e organeve kompetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen këto agjensi.

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

#### Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

#### Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

**Të zhvilloj aktivitetet në fushën e akomodimit**, duke përfshirë shërbim fjetje, bar e restorant, dhe shërbime të tjera të lidhura me to.

#### Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë e zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të asamblesës së ortakëve.

### KAPITALI I SHOQËRISË

#### Neni 6

Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruarit e një kuote, sipas nenit 72, të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm."

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga **dy kuota prej 100.000 lekë, dhe është kontribut i Ortakëve:**

1. **Irfan Balla, një kuotë në masën 70 % ose 70 000 lekë.**
2. **Albana Likaj, një kuotë në masën 30 % ose 30 000 lekë**

Ortakët mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblese së Përgjithshme .

Detyrimet e Ortakeve kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ata. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortakët nuk mbajnë përgjegjësi.

#### **Neni 7**

Ortakët mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblese së Përgjithshme .

Detyrimet e Ortakeve kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ata. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortakët nuk mbajnë përgjegjësi.

### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

#### **Neni 9**

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund ta tërheqin individualisht. Tërheqja mund të bëhet vetëm si pasojë e aktivitetit të shoqërisë.

#### **Neni 10**

Pjesëmarrja e ortakeve në shoqëri përputhet me pjesët e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Transferimi dhe shitja e kuotave ndaj të tjerëve duhet të bëhen me pelqimin e ortakeve. Realizimi i tyre bëhet me akte notoriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Asamblese së Përgjithshme.

Po kështu transferimi i kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 73, 74,75 të ligjit 9901 dt 14.04.2008 " Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Asamblese së Përgjithshme. Kuotat prej 1 leke janë të pandashme.

Në rastet e bashkëpronësive veprohet sipas ligjeve.

#### **Neni 11**





Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, si dhe emri i Ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

#### **Neni 12**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Asambleja e Pergjithshme dhe administratori i shoqerise drejton procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e pergjithshme.
- 2- Administratori .

#### **TE DREJTAT DHE KOPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

#### **Neni 13**

Asambleja e Pergjithshme ushtron kompetencat qe i jane caktuar sipas dispozitave te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" i ndryshuar.

#### **Neni 14**

Asambleja e Pergjithshme ka kompetencat e e meposhtme:

- Percakton politikat tregtare te shoqerise.
- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut .
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Ajo emeron administratorët, zëvendësin, ekspertet dhe revizorët kontabël.
- Ajo aprovon cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të saj .
- Ajo mund te shfuqizojë ndalimin e konkurrencës (Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", neni 17, pika 1), nepermjet nje autorizimi te posaçem .
- Percakton shperblimin per administratoret, ekspertet, revizoret kontabel.
- Bën transferimin e kuotave te te tretet.
- Bën lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivite te tjera te rendesishme.



- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Ka të drejtë të bëjë modifikimin e kontratës së shoqërisë.

#### Neni 15

Marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për këto qëllime.

### ADMINISTRIMI

#### Neni 16

Shoqëria administrohet nga Administratori i shoqërisë. Administratori mund të qendrojë në detyrë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërsëritje.

Asambleja e Përgjithshme vendos lejimin e një shpërblimi në favor të Administratorit për kryerjen e detyrës.

Aktualisht administratori i shoqërisë është:

**Erjona Balla**, e bija e Irfanit, shtetase shqiptare, lindur më 20/09/1999 në Durrës, Shqipëri, banuese në Durrës, me letërnjoftim nr 033071078 dhe Nr personal J959200750, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### Neni 17

Administratori mund të emerojë një ose më shumë administratore të deleguar ose përfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të veçanta duke përcaktuar kompetencat e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi dhe vendos dënimin e një shpërblimi në favor të tyre. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

#### Neni 18

Përsa i përket mënyrës së marrjes së vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Administratorit do të zbatohen nenet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

#### Neni 19

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshjeje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.



### Neni 20

Administratori ka të drejte te veproje me çdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarri veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme etj si dhe ka te gjitha te drejtat qe jane parashikuar ne ligj . Ky organ mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Pergjithshme per kategori te caktuara veprimesh.

Persa i perket drejtimit të shoqerise me Administrator ai mban dhe realizon kompetencat duke respektuar ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe konkretisht kapitullin " Mbi administrimin " neni 31 e ne vijim.

Administratori eshte i detyruar qe te mbaje regjistrat e magazinimit te cilat vihen ne dispozicion te Zyres Doganore per te mundesuar kryerjen e kontrolleve prej saj.

Administratori i shoqerise ben inventare te rregullta nje here ne muaj .

## PJESMARRJA NE VENDIME

### Neni 21

Asambleja e Pergjithshme merr vendimet per shoqerine, pasi zoteron 100 % te kapitalit te shoqerise.

Pjesmarrja e nevojshme e ortakeve per te arritur ne vendimmarrje , e te tjera ne lidhje me vendimmarrjen , mbeshtetet ne nenet 86,87,88,89 te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## MARRDHENIET E PUNES

### Neni 22

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

### Neni 23

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.



## **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

### **Neni 24**

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit dhe Asamblese se Pergjithshme, si dhe gjithe aktiviteti i shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

## **BILANCI DHE FITIMET**

### **Neni 25**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar.

Pasi paguhen detyrimet fiskale dhe veçohen fondet per zhvillimin e aktivitetit , te ardhurat qe mbeten mund te ndahen ne mes ortakeve te shoqerise dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

### **Neni 26**

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket mund te vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 27**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Asambleja e Pergjithshme percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit .

## **LIBRAT E SHOQERISE**

### **Neni 28**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i vendimeve te Asamblese se Pergjithshme.



- 2) Libri i Mbledhjeve.
- 3) Libri i vendimeve te administratorit.
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e çdo faqe duhet te jete e vulosur.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### Neni 29

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Çdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortakët e shoqerise.

### ORTAKËT E SHOQËRISË "JOEN Village" SHPK

Irfan Balla

Albana Likaj

